



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 22, datë 10.03.2014

**PËR
MIRATIMIN E “KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË
PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE TË VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIMIN
E DETYRUESHËM NË SEKTORIN E TRANSPORTIT” TË SHOQËRISË SË
SIGURIMIT “ATLANTIK” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 8, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 122, pika e, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, dhe nenit 10, pika 3, të Ligjit nr. 10 076 datë, 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm së sektorin e transportit” të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Kushteve të përgjithshme të sigurimit të përgjegjësive profesionale të vlerësuesve të dëmeve në sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” të shoqërisë së sigurimit “Atlantik” sh.a.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Enkeleda SHEHI**

Në mungesë dhe me porosi,

**Enkela IDRIZI
NËNKRYETAR**